

Për:	Operatori Ekonomik: CAPITAL X FET SHPK me adresë në Klinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	23.11.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **22.11.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **CAPITAL X FET SHPK** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **CAPITAL X FET SHPK** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.11.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë të Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **CAPITAL X FET SHPK** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJIENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-8508-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-21-024-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.11.2021**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **22.11.2021**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Me datën 11.11.2021 përmes planformës elektronike e-prokurimi si dhe përmes email zyrtarë , kemi parashtruar Sqarim për projektin në fjalë , por që nuk na është kthyer përgjigje lidhur me sqarime që kemi kërkuar .

Ne kemi kërkuar Sqarime lidhur me numrin e punëtorëve që do të angazhohen në secilin llot , duke qenë që projekti në fjalë është i ndarë në tri lloje , dhe është kërkuar analize financiare për secilin llot , pyetja jone është si do të bëhet analiza financiare kur nuk dihet sa është numri i punëtorëve që do të angazhohen në secil llot ,cili do të jete ai Operator Ekonomike i cili do të analizoj projektin në fjalë pa të dhëna të sakta sa puntore do angazhohe sa material do të shpenzohet ?

Prandaj kërkojme që të specifikohen me numer sa puntore do të angazhohme për secil llot?

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, përgjigjen tuaj e kërkesës për sqarim, ne si Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit e kemi kthyer përmes Kërkesë për Rishqyrtim të dorëzuar nga një Operator tjetër Ekonomik, **që janë të njëjta pretendimet**, dhe me B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, kemi bërë korrigjimin e gabimeve, shih korrigjimin:

Kapaciteti teknik dhe profesional	Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.	Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Shënim: Kjo kërkesë duhet të plotësohet, për Lot 1 dhe Lot 3, Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për Dy (2) Lote, vlen vetëm vlera e kërkuar sipas Kërkesës Nr. 1 e cila duhet të përmbushet nga OE.
---	---	--

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Po ashtu tek FDT , ndarra ne llotet , tenderuesi mund te merr pjes ne te gjitha llotet ndersa te shperblehet vetem me nje apo nese nuk pranohen oferta vlen shembulli i Rruopp-së , duke qene qe nuk keni dhene sqarime ju si AK jeni duke fazorizuar nje OE , dhe kjo parasheh shkelje te LPP , nga qe po te ishte e qarte sa puntore do angazhohen per secilin llot athere sigurisht numri i ofertave do te ishte me i madhe .

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, për këtë aktivitet të prokurimit është bazuar në **Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik**, duke respektuar plotësisht Rregulloren dhe duke marrë shembull, Ne dosjen e tenderit, tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), si në vijim:

Ndarja ne Lote	2.5	Ndarja ne Lote: Po ☒ Objekti i kontratës është i ndare në Tenderuesi mund të paraqesë tender: ☒ Të gjitha pjesët Secila pjesë e lot-it është e shënuar në <u>specifikacionet teknike</u> , shih Aneksin 1. Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 1 Në rast se Tenderuesi ofron çmimin më të ulët në më shumë se 1 LOT atëherë ai do të shpërblehet me kontratë për LOTIN që i cili është ma i leverdishëm për Autoritetin Kontraktues, dhe ne rast te mos pranimit te shume ofertave, vlen shembulli i RrUOPP-së, (Shembull: Ndarja në Lote: 7 Lot-e)
----------------	-----	--

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Në bazë të dosjeve të tenderit ne nje projekt te ngjajshem , autoritet kontraktues ne ate komune ka kerkuar qe ne baze te ligjit nje puntore pastron 450 m2 brenda nje orar prej 8 oreshe , “Staf i te punesuaresve ne kete aktivitet, ne baze te Noram caktuar me Ligj min 450 m2 hapsire ne nje ndrrim”

Nese llogarisim metrat katrore qe keni parapare per kete projekt qe jane :

Llot 1 jane 14.527,16 m2

Llot 2 jane 370,00 m2

Llot 3 jane 9.243,20 m2

Ne total jane parapare 24.140,36 m2 nese llogarisim 450.00m2 per nje puntore

Del qe per kete projekt duhet te angzhohen 54 puntore dhe jo 25 siq keni parapare .

Duke u bazur ne faktet e larteshenuar kerkojme nga Autoritet kontraktues Rahovec ta rishqyrtojë Kerkesen tone , duke na tregu sa puntroe do angazhohen secil llot , duke marr parasyshe te drejtat e puntorit ne baze te ligjit ku parashihet 450m2 te pastrohen brenda orarit prej 8 oresh si dhe duke i larguar kerkesa diskriminuse siq jane iso standarndet , nese Kerkesa jone nuk gjen aporvim atëhere jemi te obliguar që lenden ta dergojme ne OSHP si dhe institucione tjera relevante.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani.

Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, minimum. 25 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

Shënim: Kjo kërkesë duhet të plotësohet, për Lot 1 dhe Lot 3,

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për Dy (2) Lote, vlen vetëm vlera e kërkuar sipas Kërkesës Nr. 1 e cila duhet të përmbushet nga OE.

Kërkesa 3, pika c: Operatori Ekonomik obligohet që të punësoi minimum: 25 punëtorët nga Lista e Autoritetit Kontraktues.

Dëshmia 3, Pika c: Një Deklaratë që obligoheni që të punësoi minimum 25 punëtorët nga Lista e Autoritetit Kontraktues – duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

Ne baze të Kriterëve të sipërpërmendur sipas Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, numri i punëtorëve që do të angazhohen për një LOT është i mjaftueshëm.

Për Lot 1 janë 25 punëtor nga Lista e Operatorëve Ekonomik e punëtorëve që do të angazhohen dhe 13 punëtor nga Lista e Autoritetit Kontraktues sipas Kërkesës 3 pika c.

Për Lot 2 janë 25 punëtor nga Lista e Operatorëve Ekonomik e punëtorëve që do të angazhohen dhe 12 punëtor nga Lista e Autoritetit Kontraktues sipas Kërkesës 3 pika c.

Kurse se si do të pastrohen dhe mirëmbahen objekte janë të përshkruar te Specifikimet Teknike të detyrueshme, ku është cekur Orari Pastrimit, Furnizimi me material dhe obligime tjera që janë të përshkuara për objekte që janë të specifikuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit